



KQZ
U PROTOKOLLUA
NR. 2201/PROT
DATE 2.4.2021

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
PROKURORI I PËRGJITHSHËM

Nr. 492/1 Prot.

Tiranë më, 02.04.2021

Lënda: Kthim përgjigje.

Z. ILIRIAN CELIBASHI
KOMISIONER SHTETËROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONI QËNDROR I ZGJEDHJEVE

TIRANË

I nderuar z.Celibashi,

Në përgjigje të kërkesës/shkresës tuaj me nr.2201, datë 17.03.2021 “Kërkesë për informacion”, lidhur me numrin e procedimeve të regjistruara, numrin e procedimeve në gjykatë dhe numrin e personave të dënuar për vitin 2020, etj;

Në mbështetje të nenit 107/1 të ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ju dërgojmë të dhënat statistikore për veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, të parashikuara në nenet 325 deri 332/a të Kodit Penal, në tabelen Aneksi 1, bashkëlidhur.

Në këtë tabelë janë pasqyruar të dhënat statistikore për vitin 2020 me treguesit në shifra për veprat penale përkatëse dhe gjithsejt: -regjistruar procedime dhe të pandehur, -gjykuara procedime dhe të pandehur, -persona të dënuar, -mbetura në gjykim çështje dhe të pandehur, si dhe -tregues me të dhëna për të pandehurit, ku përfshihen, -gjinia të rritur, -arsimi, -gjendja shoqërore, -vend banimi apo qëndrimi, dhe -gjendja gjyqësore.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

PROKURORI I PËRGJITHSHËM

OLSIAN ÇELA



ANEKSI NR.1-TE DHENA STATISTIKORE PER VEPRAT PENALE QE PREKIN ZGJEDHJET E LIRA DHE SISTEMIN DEMORAKIK TE ZGJEDHJEVE PER VITIN 2020

VEPRAT PENALE PËR ZGJEDHJET E LIRA-NËNET KODI PENAL	Viti 2020 Regjistrra, Derguar në gjykate, çështja/akuza, pafajshëm						Gjithëse (S4)	Mbeten në Gjykim (S3-S4) dhe në hetim	Gjinia të mitur 14-18 vjeç				Gjinia të rritur mbi 18-vjeç				Shtetas të huaj				Arsimi			Gjendja shoqërore						Vend		Gjendja																				
	Nr. Procedimeve Regjistruara	Nr. procedime në gjykatë	Nr.i pandehurve Regjistruar	Nr. Pandehurve në gjykate	Nr. Pandehurve dënuar	Nr. Pandehurve pushuar gjykata			Nr. Pandehurve pafajësi gjykata	Çështje	Pandehur	Arrest. Burg	Çështje	Pandehur	Arrest. burg	Meshkuj	Femra	Gjithësej	Meshkuj	Femra	Gjithësej	Të huaj	Pa shtetësi	Me imunitet	Gjithësej	Deri 9 -Vjeçar	Të Mesëm	Të Lartë	Gjithësej	Gjith.Sek Shtetëror	Funksionar	Np-nivel lartë	Np-nivel mesëm	Np-nivel ulët	Np-nivel eksekutus	Nepunës i thjeshtë	Gjith.Sek Privat	Pa punë	Gjithësej	Gjithësej Gjendja shoqërore	Qytet	Komunë	Gjithësej	Përsëritës Njëta V.Penale	Perserites V.P Ndryshme	Tëpa Dënuar	Gjithësej					
	N. 325	N. 326	N. 326/a	N. 327	N. 327/a	N. 328			N. 328/a	N. 328/b	N. 329	N. 330	N. 330/a	N. 331	N. 331/a	N. 332	N. 332/a	Totali	N. 325	N. 326	N. 326/a	N. 327	N. 327/a	N. 328	N. 328/a	N. 328/b	N. 329	N. 330	N. 330/a	N. 331	N. 331/a	N. 332	N. 332/a	Totali	N. 325	N. 326	N. 326/a	N. 327	N. 327/a	N. 328	N. 328/a	N. 328/b	N. 329	N. 330	N. 330/a	N. 331	N. 331/a	N. 332	N. 332/a	Totali		
	1	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	11	3	4	5	18	0	11	41	0	0	0	0	0	0	0	45	3	48	0	0	0	5	34	5	44	2	0	0	25	27	27	37	13	50	2	0	36	38



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

sp



KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data 17.03.2021 Lënda: Kërkesë për informacion.

Nr. Protokolli 2201 DREJTUAR: Z. OLSIAN ÇELA
PROKUROR I PËRGJITHSHËM

I nderuar z. Çela,

Neni 167/1, paragrafi i parë dhe i tretë, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, përcakton se "KQZ u kërkon informacion të rregullt organeve të policisë dhe të prokurorisë për hetimin e veprave penale në fushën e zgjedhjeve. Informacioni kërkohet me të dhënat për çështjet penale, personat nën hetim, kohëzgjatjen e hetimit dhe përfundimin e tij, të dhënat për kërkesat e prokurorisë për gjykim, kohëzgjatjen e gjyqimit dhe përfundimin e tij, të dhënat për ankimimin e vendimeve gjyqësore, shkakun e ankimimit, si dhe të dhënat për faktin nëse çështjet janë gjykuar në apel ose në Gjykatën e Lartë dhe rezultatit e këtij gjykimi. Pjesë e informacionit duhet të jetë edhe informacioni për ekzekutimin e dënimeve".

Më tej, paragrafi i tretë përcakton se "KQZ është i detyruar që të mbajë, përditësojë dhe publikojë statistikë të rregullt për hetimet penale, me të gjithë informacionin e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, si dhe të informojë Kuvendin gjatë raportimeve periodike ose vjetore, si zë më vete, për gjendjen e hetimeve penale për çështjet zgjedhore".

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve duhet të paraqesë raportin në Kuvend për veprimtarinë e KQZ-së për vitin 2020, pjesë e të cilit duhet të jetë edhe gjendja e hetimeve për çështjet zgjedhore.


Duke marrë në konsideratë përcaktimet e Kodit Zgjedhor, lutemi të na vini në dispozicion të dhëna statistikore në lidhje me: numrin e procedimeve penale të regjistruara, numrin e procedimeve në gjykatë, si edhe numrin e personave të dënuar për vepra penale për krimet zgjedhore për vitin 2020.

Gjithashtu, kërkojmë të dhëna statistikore në lidhje me karakteristikat e shtetasve për këto vepra penale që kanë të bëjnë me: gjininë, moshën, arsimin, gjendjen shoqërore, vendbanimin, si edhe gjendjen gjyqësore të tyre.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Kopje 3
Aftai i ruajtjes 5 vjet
Punoi
Y.Merkaj

